



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
KABINETI

Nr. 5312/1 prot.

Tiranë, më 03.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

ZNJ. A. D

Adresa: Pallati "Sky Tower", Tiranë

E nderuar znj. A. D

Në përgjigje të shkresës suaj, dërguar në mbështetje të ligjit nr. 119/ 2014, "Për të drejtën e informimit", lidhur me kërkesën për informacion mbi të dhëna statistikore që ISSH administron, ju bëjmë me dije sa vijon:

Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka të përcaktuar në përmbajtjen e tij normat e vendosura nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, si parimin e trajtimit të barabartë për çdo individ që i nënshtrohet këtij legjislacioni, përfshirë edhe shtetasit e huaj.

Neni 7, i këtij Ligji, lidhur me mbrojtjen për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit dhe shtetasit e huaj përcakton se "Sigurimet shoqërore iu japin mbrojtje edhe:

a) shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dypalëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

b) shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri".

Për personat e punësuar (përfshirë edhe shtetas të huaj) legjislacioni i sigurimeve shoqërore detyron punëdhënësin të mbajë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të bëjë derdhjen e tyre në llogari të administratës tatimore.

Bazuar në nenin 13, të Ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, kontributet paguhen nga:

1. Kontributet do të paguhen nga personat e siguruar;

2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi;

3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në rast të mospagesës së kontributeve, legjislacioni i sigurimeve shoqërore parashikon sanksione referuar Nenit 16 të Ligjit nr.7703/1993: *Ndaj punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, që nuk zbatojnë afatet dhe procedurat e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, zbatohen sanksionet e përcaktuara në Ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

Në lidhje me kërkesën tuaj për statistika të numrit të kontribuesve të huaj të siguruar ju sqarojmë se, të dhënat mbi numrin e kontribuesve që kanë paguar detyrimet për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, sigurohen nga organet tatimore, dhe nuk janë të strukturuar sipas ndarjes së shtetësisë.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, disponon të dhënat mbi numrin e kontribuesve, të detajuara sipas skemave kontributive ku çdo individ është pjesëmarrës.

Në skemën e sigurimit të detyrueshëm për të cilën, përgjegjës për mbledhjen e kontributeve janë organet tatimore, numri i kontribuesve raportohet nga kjo strukturë në ISSH në total, pa ndarje shtetësie,

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për mbledhjen e kontributeve për dy skemat kontributive, skema e Të vetëpunësuarve në Bujqësi dhe e Sigurimit Vullnetar, të cilat janë skema vetëm për shtetasit shqiptarë.

Shtetasit e huaj të siguruar në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore kërkojnë informacion pranë ISSH, për historikun e tyre kontributiv, të cilin kanë vështirësi ta aksesojnë nga portali unik qeveritar e-Albania.

Për të punësuarit e huaj në Republikën e Shqipërisë pajisja me numër identifikimi për qëllime tatimore, realizohet nëpërmjet regjistrimit nga punëdhënësi pranë Organeve Tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë numër mund të identifikohen në sistemin elektronik të sigurimeve shoqërore.

Informacioni i detajuar për të gjithë shërbimet që ISSH ofron si për shtetasit shqiptarë edhe ata të huaj, është i publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore <https://www.isssh.gov.al/>

Aktualisht, Republika e Shqipërisë ka 16 marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore në fuqi. Informacioni mbi këto marrëveshje është i publikuar në linkun: <https://www.isssh.gov.al/marredheni-nderkombetare>.

Marrëveshjet dypalëshe për sigurimet shoqërore bazohen mbi parimet e koordinimit të skemave kombëtare të sigurimeve shoqërore, në veçanti mbi parimin e totalizimit të periudhave të sigurimit,

eksportueshmërisë së përfitimeve, bashkëpunimit administrativ ndërmjet institucioneve kompetente dhe trajtimit të barabartë të shtetasve.

Në këtë kuadër, shtetasit shqiptarë dhe të huaj trajtohen në të njëjtën mënyrë për sa i përket të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet, për aq kohë sa janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit shqiptar dhe i legjislacionit të shtetit tjetër palë kontraktuese.

ISSH mbledh dhe administron të dhëna statistikore mbi kërkesat e trajtuara në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore. Këto kërkesa lidhen me persona që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit shqiptar dhe i legjislacionit të shtetit tjetër palë kontraktuese, si dhe me persona të tjerë të cilëve u lind e drejta nga këta persona, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve përkatëse.

Për këtë arsye, të dhënat statistikore administrohen sipas shtetit palë, llojit të kërkesës dhe statusit të trajtimit të saj, pa u specifikuar shtetësia apo kombësia e personave të përfshirë.

Nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së parë me Republikën e Turqisë e deri më 31 janar 2026, ISSH ka trajtuar në total 14.538 praktika. Këto praktika përfshijnë verifikim dhe konfirmim të periudhave të sigurimit shqiptarë dhe të huaja, shkëmbim informacioni dhe dokumentacioni, lëshim dhe shkëmbim të certifikatave të mbulimit për legjislacionin e zbatueshëm, si dhe trajtim të kërkesave për pension sipas legjislacionit të secilit shtet.

Në kuadër të parimit të totalizimit të periudhave, marrëveshjet dypalëshe kanë mundësuar lidhjen e pensioneve të pleqërisë edhe në rastet kur periudhat e sigurimit në Shqipëri janë më të vogla se kushti minimal prej 15 vitesh i parashikuar nga legjislacioni i brendshëm.

Aktualisht janë lidhur 460 pensione pleqërie me më pak se 15 vite sigurim në Shqipëri, me një shumë mujore totale prej 5.230.667 lekë. Këto pensione nuk mund të ndahen sipas shtetësisë së përfituesve, pasi në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe personat konsiderohen subjekte të të dy legjislacioneve dhe përfitojnë të drejta në bazë të periudhave të sigurimit të realizuara në të dy shtetet.

Gjithashtu, ISSH realizon transferimin e pensioneve për përfituesit që jetojnë në shtetet me të cilat Shqipëria ka marrëveshje në fuqi, dy herë në vit, gjatë muajve prill dhe tetor. Deri në tetor 2025, transferohen jashtë shtetit 191 pensione. Edhe këto raste nuk mund të ndahen sipas shtetësisë së përfituesve, pasi transferimi lidhet me zbatimin e marrëveshjeve dhe jo me kombësinë e personit. Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes me Italinë gjatë muajit prill, pritet që numri i pensioneve të transferuara jashtë shtetit të rritet.

Për çdo informacion shtesë apo sqarim të mëtejshëm, mbetemi në dispozicionin tuaj !